# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-436494**
VERSIONI

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Dyshimet për rrëmbim dhe tetë vite pa përgjigje, Elvis Troqe shpallet zyrtarisht i zhdukur |
| ADRESA | `https://www.gazetatema.net/kronika/dyshimet-per-rrembim-dhe-tete-vite-pa-pergjigje-elvis-troqe-shpallet-zyr-i585357` |
| BURIMI | gazetatema.net |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 11 shtator 2026, 10:13:42 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 11 shtator 2026, 10:50:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `33d80084f2a368dbf32a9a9a36956fbd5e1853ae8f14d8c741231e8b8e195dec` |
| TEKSTI | `03cdad7de32111e2487e92eb6342f83e1b5bd3d7ff264f5967edc9396e4ecb76` |
| PAMJA | `8b209b550c87ac5335633ea0f4bcd5f99df7962bfae97cd8b7202066aa111143` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `6c58f2abc5e0c960cc5edbf4c586b46b4be94003ca751dd6fd06f145b56c2504` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | – |
| ANKORIMI | nuk është ankoruar ende<br>*Kjo hyrje nuk është përfshirë ende në asnjë pemë Merkle të dërguar. Zinxhiri i hash-eve provon rendin dhe integritetin; koha jo.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/6c58f2abc5e0c960cc5edbf4c586b46b4be94003ca751dd6fd06f145b56c2504`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored · dritarja 1280×1024 px

# Dyshimet për rrëmbim dhe tetë vite pa përgjigje, Elvis Troqe shpallet zyrtarisht i zhdukur

11 Shtator 2026, 12:50Kronika TEMA

Dyshimet për rrëmbim dhe tetë vite pa përgjigje, Elvis Troqe

Tetë vite pas zhdukjes së 24-vjeçarit Elvis Troqe, Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë e ka shpallur zyrtarisht të zhdukur të riun.

Vendimi është marrë më 15 qershor 2026 dhe tashmë është publikuar në Fletoren Zyrtare. Në bazë të tij, nëna e Elvisit, Marsela Troqe, është caktuar kujdestare për administrimin e pasurive të luajtshme dhe të paluajtshme të djalit të saj.

Elvis Troqe u zhduk tetë vite më parë dhe që prej asaj kohe nuk ka pasur më asnjë gjurmë të tij. Sipas të dhënave të bëra publike gjatë hetimeve, i riu ndodhej në rrugën kryesore kur u afrua një automjet tip "Mercedes-Benz", me ngjyrë gri.

Troqe është parë duke përshëndetur drejtuesin e automjetit dhe më pas është futur brenda tij. Sipas të dhënave të hetimit, në makinë ndodheshin edhe dy persona të tjerë. Pas këtij momenti, 24-vjeçari nuk është parë më.

Rasti ka ngritur prej kohësh dyshime se zhdukja nuk ka qenë një largim i zakonshëm. Në kuadër të hetimeve, Prokuroria e Vlorës kishte evidentuar elementë që mund të lidhen me veprën penale të "rrëmbimit të personit".

Për zbardhjen e ngjarjes janë kryer një sërë veprimesh hetimore, përfshirë edhe kontrolle në banesën e Inez Hajrullës. Ky i fundit ka deklaruar gjatë hetimeve se ditën e zhdukjes së Troqes kishte dalë për të kryer fizioterapi dhe se nuk kishte pasur njohje me 24-vjeçarin.

Pavarësisht hetimeve dhe veprimeve të kryera ndër vite, fati i Elvis Troqes vijon të mbetet i paqartë. Vendimi i gjykatës për shpalljen e tij të zhdukur vjen pas tetë vitesh pa asnjë informacion të konfirmuar për vendndodhjen e të riut.

---

## Lini një Përgjigje

Koment *

Emër *

POSTOJE KOMENTIN

Po trafikonte 11 klandestinë nga Pakistani dhe Bangladeshi drejt vendeve të BE, arrestohet 27-vjeçarit në Korçë

Po trafikonte 11 klandestinë nga Pakistani dhe Bangladeshi drejt vendeve të BE, arrestohet 27-vjeçari në Korçë

11:50 Kronika

Luan Baçi në SPAK, deputeti demokrat paraqitet së bashku me avokatin

11:09 Kronika / 2 komente

Merr drejtimin e Ministrisë së Brendshme, Ervin Demo: Përgjegjësi e madhe, do të çojmë përpara prioritetet e qeverisë

11:00 Kronika / 1 koment

PROFIL: Kush është ministri i ri i Brendshëm?

10:40 Kronika / 18 komente

“Kallëzimi në SPAK është idiot”, Manjani: Ligji e ndalon, por gjyqtarët dhe prokurorët po bëjnë grevë…

23:15 Kronika / 12 komente

U kap me armë zjarri dhe jelek antiplumb, arrestohet pronari i një hoteli në Fushë-Krujë

23:05 Kronika / 1 koment

Trafik armësh? Drejtuesi i KAYO mohon akuzat: Nuk jemi përfshirë! (Çfarë thotë për Ron Yeffet?)

22:25 Kronika / 6 komente

Patos-Marinzë/ Banorët kërkojnë zgjidhje përfundimtare nga Bankers për qiratë e tokave, ngujohen në zyrat e kompanisë

22:05 Kronika / 2 komente

Zjarret në vend/ 30 vatra gjatë ditës, 7 mbeten aktive! Mbi 400 forca në terren

21:45 Kronika

Kontroll në burgun e Shkodrës, kapet i dënuari me drogë dhe celular

21:15 Kronika / 1 koment

### Më të lexuarat

**24 oret e fundit**

**Javen e fundit**

**“Berisha gënjeu demokratët” - Bejko: Nuk ka më të drejtën...**

09:45 Politika / 20 komente

**Plas në PD, Çim Peka sulmon Belind Këlliçin: Ky idioti po...**

15:45 Politika / 29 komente

**EKSKLUZIVE/ MUHAMED HALILI: Ju rrëfej "aferën e armëve" m...**

15:30 Dossier / 11 komente

**Gjyqtarët kallëzojnë në SPAK ministrin e Financave, reago...**

13:04 Politika / 51 komente

**'Kallëzim se po zbatoj ligjin', ministri Malaj publikon p...**

19:05 Politika / 77 komente

## Blog Tema

**Një telash më shumë për Partinë Demokratike**

19:10 Blog / 19 komente

**Kur protesta nuk shqetëson pushtetin, por merr peng qytetarin**

18:28 Blog / 33 komente

**Sikur Lana të mbyste bulevardin me baltë**

17:05 Blog / 8 komente

## Lajme ekskluzive!

Nëse doni të jeni i pari për t'u informuar mbi lajme ekskluzive, regjistrohuni më poshtë.

Numri juaj i telefonit REGJISTROHU
Ju mund të ç'regjistroheni në çdo moment.

Powered by Tomorrow.io

TemA është një gazetë e përditshme e palidhur politikisht e botuar në Tiranë, Shqipëri në gjuhën shqipe. E themeluar në korrik 1999, TemA është një nga gazetat ditore më të vjetra në Shqipëri dhe aktualisht shet rreth 15,000 kopje ditore në mbarë vendin.

Built and Monetized by


- Politika
- Kronika
- Editorial
- Blog
- Bota
- Sport
- Shëndeti
- Turizëm
- Sociale
- Ekonomia
- Antena
- Rajoni
- Kulturë
- Lifestyle
- Dossier
- Hi-Tech

- Kontakt
- Te dhënat personale
- Cookies


Built and Monetized by

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.